



In medias res

Ndryshimet në arsim pronësi e qytetarëve!

Ndryshimet në arsim janë komplekse, shumë të ndërlikuar, sepse me të preken interesat e të gjithë qytetarëve. Nëse nga ndryshimet në arsim nuk përfitojmë të gjithë qytetarët e një vendi, ato ndryshime nuk janë efikase dhe efektive sepse me to nuk sigurohet një edukim dhe arsim cilësor për të gjithë. Këto ndryshime që nuk janë në dobi të gjithë qytetarëve të një vend, nuk kanë qëllim të duhur moral, sepse krijojnë kushte për pabarazi, për pa drejtësi sociale, për diskriminim të llojeve dhe të natyrave të ndryshme, me çka nuk garantohet një mjedis miqësor për të gjithë shoqërinë me njeriun në qendër. Pabarazia në arsim e nxitur nga ndryshimet që synojnë daljen nga kriza çojnë drejt konflikteve të reja të bazuara në identitete, kulturore, gjinore, etnike dhe ekonomike. Në këto ndryshime mbillet bërthama një krize të re, e një të keqeje e cila nxit konflikte sociale, varfëri, imoralitet, krim të organizuar dhe qeverisje autoritare, kleptokratike dhe oligarkike.

Meqë me ndryshime duhet krijuar dhe shanse dhe mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët, atëherë edhe pjesëmarrja sa më e madhe e qytetarëve në këto ndryshime është imediate dhe e domosdoshme. Për këtë arsye ndryshimet në arsim duhet të shndërrohen në pronë të qytetarëve.

Pronësia mbi ndryshimet në arsim sigurohet nëse ndryshimet në arsim organizohen nga "Lartë - poshtë" dhe nga "Poshtë - lartë". Kjo rrugë e ndryshimeve siç shihet nisat nga lartë, nga ndërtesat dhe hartuesit politikave zhvillimore të arsimit (nga Parlamenti, Qeveria, MASHT). Këto struktura marrin vendime për ndryshime. Vendimet mund merren varësisht nga gjendja e vetë sistemit të arsimit. Nëse sistemi i arsimit është stabil, efikas dhe efektiv, atëherë këto organe marrin vendim për ndryshime reformuese me të cilat sigurohet përparimi i vazhdueshëm i sistemit të arsimit. Kjo ndodh atëherë kur shteti dëshiron të mbajë hapin me zhvillimet, teknike, teknologjike dhe me tregun botëror të punës.

Por kur shteti dëshiron që të bëjë avancime dhe përparime më të mëdha ekonomike, shkencore, teknike dhe teknologjike atëherë merren vendime për ndryshime inovative, për futjen e risive dhe të novacioneve më të cilat bëhen kërcime cilësore në sistemin e arsimit.

Por kur shteti është në një krizë të thellë, siç është rasti i Kosovës, atëherë këto organe duhet të marrin vendime për ndryshime transformuese që janë të përafërta me ndryshimet revolucionare. Në këtë rast ndryshojnë të gjitha pjesët, elemente e sistemi i arsimit: koncepti, struktura, qeverisja, korniza ligjore, kurrikulat, tekstet, mënyrat e përgatitjes së personelit mësimor, mënyra e monitorimit, mbikëqyrjes dhe të vlerësimit të ndryshimeve të bëra.

Në të gjitha këto raste, organet vendimmarrëse, vendimet e tyre i bazojnë mbi hulumtimin e nevojave reale të qytetarëve dhe të nevojave të shtetit për zhvillimin teknik dhe teknologjik.

Duke i inkorporuar nevojat e qytetarëve, qytetarët bëhen agjent të ndryshimeve në sistemin e arsimit. Në anën tjetër pjesëmarrja e prindërve, nxënësve, udhëheqësve, komunitetit arsimor në ndryshime me ide, mendime, ndryshimet i bëjnë gjithëpërfshirëse, të pasura dhe të dobishme për të gjithë qytetarët e vendit.

Shkroi: Halim Hyseni

Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Në kuadër të Programit të MKLSH, më 7-8 shkurt 2009 është mbajtur seminari i katërt me mësimdhënësit e Prishtinës (një grup), Pejës, Ferizajit, Gjilanit, Gjakovës dhe Mitrovicës. Ky seminar për grupin e dytë të mësimdhënësve të Prishtinës është mbajtur më 14-15 shkurt. Seminari është mbajtur sipas agjendës së planifikuar nga KEC dhe nga raportet e trajnerëve kuptohet se çdo gjë është zhvilluar sipas planifikimit.

■ Më 31 janar -1 shkurt dhe 14-15 shkurt 2009 janë mbajtur seminari i 5 dhe i 6 me mësimdhënës të Gjakovës, të cilët janë duke u trajnuar në bashkëpunim me Qendrën Didaktike në Gjakovë.

■ Gjatë muajit shkurt është bërë monitorimi i 36 mësimdhënësve të komunës së Podujevës, të cilët janë duke e vjuar trajnimin e MKLSH me vet financim. Nga fletëmonitorimet dhe raporti i takimit gjysmë-ditore vërehet se trajnerët janë të kënaqur me përkushtimin e mësimdhënësve për të implementuar teknikat e mësuara në kuadër të programit të MKLSH-së.

Krijimi i mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla

■ Në përputhje me projektin gjatë muajit shkurt, në funksion të vetëdijësisimit të opinionit për rolin e mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane, është përgatitur poster i cili do

të shpërndahet në institucionet arsimore. Po ashtu gjatë këtij muaji është mbajtur një tryezë e rrumbullakët në Prizren me temën: “Pse në shkollë nuk mund të bëhet siguria e plotë”



■ Në ndërkohë është përgatitur DRAF-RAPORTI i detajuar për hulumtimin e shpejt i cili është bërë me qëllim që të vlerësohet puna e komiteteve shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës; këshilltarëve për të drejtat e fëmijës, si dhe për gjendjen e të drejtave të fëmijës në përgjithësi. Draft Raporti mund të gjendet në ueb faqen: www.childrights-ks.org.

■ Gjithashtu është përgatitur edhe Modeli i Rrjetit të Mbrojtës të mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane. Ky model do të diskutohet në punëtorinë që do të zhvillohet me datën 11 mars 2009

Trajnimi i mësimdhënësve të arsimit parauniversitar sipas programit edukimi multikulturor

■ Në përputhje me projektin me datën 10 shkurt është mbajtur mbledhja konsultative me pjesëmarrës në të cilën është bërë prezantimi i projektit dhe është mbajtur një ligjëratë në temën: “Pak fjalë për rolin dhe rëndësinë e edukimit multikulturor në kohën globale dhe postmoderne - Një prolog para fillimit të trajnimit”



■ Gjatë këtij muaj është mbajtur trajnimi pesëditor. Në trajnim janë përfshirë 23 pjesëmarrës, kryesisht mësimitdhënës të arsimit parauniversitar. Gjatë këtij trajnimi pesëditor mësimitdhënësit kanë fituar dije të vlefshme për edukimin multikulturor dhe kompetenca për veprim ndërkulturor në fushën e edukimit dhe krijimit të shkollave multikulture



Trajnimi i mësimitdhënësve të historisë

■ Më datat 20 dhe 21 shkurt, në Prishtinë, përkatësisht në Prizren janë organizuar dy trajnime njëditore. Trajnimet u realizuan nga KEC në bashkëpunim me Qendrën për Demokraci dhe Pajtim në Evropën Juglindore (CDRSEE). Pjesëmarrës në të dy trajnimet ishin 54 mësimitdhënës nga të gjitha qytetet e Kosovës. Në fund të seminarit të gjithë mësimitdhënësve iu shpërnda kompleti prej 4 librave të historisë

KOSOVISION Contest

■ Pasi që mësimitdhënësit ishin të njohur për punën të cilën do ta zhvillojnë

më tutje, muaji shkurt iu shkoi duke bërë përgatitjet e projektit. Të gjitha klasat fituese kanë bërë përshkrimin e projekteve të tyre. Ato projekte janë vlerësuar nga ekipi Zviceran dhe janë bërë kontrata individuale me secilin nga mësimitdhënësit. Të gjithë mësimitdhënësit do të fillojnë implementimin e projektit nga fillimi i muajit shkurt dhe deri më 6 maj ata duhet ti kenë projektet e përfunduara në shkollat e tyre në bazë të planit të paraparë.

■ Po ashtu, në kuadër të këtij projekti është organizuar edhe një udhëtim dy ditor në Brezovicë me nxënësit e tri klasave fituese të çmimit të përzgjedhur me short.



Rreth 70 fëmijë nga Gjakova, Malisheva dhe Kaçaniku, kanë gëzuar këtë të drejtë në këtë udhëtim. Fëmijët ishin të shoqëruar nga mësimitdhënësit e tyre. Atje u organizuan lojëra të shumta për fëmijë. RTK ishte prezente dhe po ashtu bëri disa xhirime rreth lojës dhe aktiviteteve të zhvilluara në Brezovicë.



Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit

■ Në kuadër të këtij projekti kanë filluar edhe aktivitetet e parapara me projekt. Fillimisht është caktuar struktura udhëheqëse e projektit dhe është mbajtur takimi i parë ku këta pjesëmarrës janë njoftuar edhe me projektin edhe me aktivitetet të cilat do të zhvillohen në projekt.

Sipas projektit është paraparë edhe zgjedhja e 30 shkollave të cilat do të jenë përfitues direkt të projektit. Shkollat janë zgjedhur nga katër komunat, Komuna e Prishtinës, Fushë Kosovës, Prizrenit dhe Dragashit. Në Prizren janë mbajtur edhe takimet me drejtoritë Komunale të Arsimit ku edhe është pranuar nga ana e tyre bashkëpunimi për aktivitetet e mëtutjeshme. Në Prishtinë pritet që këto takime të zhvillohen gjatë muajit mars kur edhe do të fillojmë me vizitat-takimet e para me shkollat e zgjedhura në projekt.

Prevention on Peer Violence

■ KEC së bashku me Fondacionin "Together" nga Sllovenia, këtë muaj kanë lidhur një marrëveshje për një projekt i cili ka të bëjë për dhunën në shkolla. Projekti është një vjeçar dhe do të fillojë implementimin gjatë muajit mars. Gjatë muajit shkurt janë bërë përgatitjet e para të projektit dhe janë caktuar aktivitetet e projektit. Ky projekt do të fillojë me aktivitetin e parë në muajin mars ku do të bëhet një trajnim i mësimdhënësve nga 10 shkolla të Komunës së Prishtinës. Mësimdhënësit e trajnuar do të vazhdojnë të mbajnë punëtori në shkollat e tyre.

Cilësia e arsimit në regjionin e Dukagjinit (AVSI-CESAL)

■ Projekti është duke shkuar mirë. Jemi në fund të fazës së shpërndarjes/mbledhjes së pyetësorëve. Në të fillim të muajit mars do të fillojë përpunimi i të dhënave. Mendohet që ky proces të përfundojë brenda një muaji.

Përgatiti: Petrit Tahiri